REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr.3050/3 Prot. Vlorë më, 03.11.2026

VENDIM

Nr.66, datë 03.11.2026

PËR
MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË VEPRIMTARISË FINANCIARE PËR UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026

Në mbështetje të neneve 32 dhe 49 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 25 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, të Udhëzimit nr. 24, datë 21.10.2019, "Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 5, datë 19.02.2018, 'Për përcaktimin e elementeve përbërës të raportimit vjetor dhe afateve për raportim të institucioneve të arsimit të lartë'", i ndryshuar, si dhe të propozimit të Administratorit të Universitetit, përcjellë me shkresën nr. 2898 prot., datë 22.10.2026, Bordi i Administrimit, në mbledhjen e datës ..2026, vendosi:

VENDOSI :

1. Të miratojë raportin vjetor të veprimtarisë financiare të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë për vitin akademik 2025-2026 sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Administratori i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, për përcjelljen e raportit vjetor pranë Ministrisë së Arsimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Anëtarët
Alma Bakiu
Enida Pulaj
Elmira Kushta
Ledina Mançka
Orkida Hasani

KRYETAR
Saniela Xhaferi

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288
Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al